



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më __.__.2023

VENDIM

Nr. 43, datë 27.01.2023

“PËR

**PËRFUNDIMIN PA VENDIM PËRFUNDIMTAR TË PROCEDURËS SË
VLERËSIMIT ETIK DHE PROFESIONAL ME QËLLIM PËRCAKTIMIN E
NIVELIT TË VLERËSIMIT (GRADIMIN), PËR PERIUDHËN E VLERËSIMIT 2013-
2016, PËR GJYQTAREN {...}”**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbledhjen e datës 27.01.2023, si u njoh me materialet e çështjes dhe relacionin e përgatitur nga relatorja znj. Irena Plaku, si dhe, pasi shqyrtoi propozimin për përfundimin pa vendim përfundimtar të procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin), për periudhën e vlerësimit 2013-2016, për gjyqtaren {...},

VËREN:

I. FAKTET E ÇËSHTJES DHE PROCEDURA E ZHVILLUAR

1. Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në parashikimet e nenit 85 dhe 97 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (Ligji për Statusin), nenit 25 të Ligjit nr. 48/2019 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 96/2016” dhe Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 263, datë 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve”, me vendimin nr. 440, datë 01.11.2022, ka vendosur fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin) të gjyqtarëve që kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit. Ndër gjyqtarët për të cilët ka filluar procedura e vlerësimit është edhe znj. {...}, gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, aktualisht në skemë delegimi në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

2. Nëpërmjet këtij vendimi, bazuar në procedurën e shortit, për vlerësimin e gjyqtares {...} për periudhën e vlerësimit 2013-2016, është përzgjedhur relator znj. Irena Plaku dhe nëpunëse përgjegjëse për vlerësimin znj. Gilda Hoxha. Nëpërmjet postës elektronike, në 02.11.2022, bazuar në nenin 85 dhe 89 të Ligjit për Statusin, gjyqtares i është njoftuar vendimi për fillimin

e procedurës së vlerësimit të përshpejtuar të detyruar dhe emrat e vlerësuesve. Po në këtë datë, gjyqtarja ka dërguar deklaratën për adresën elektronike dhe kontaktet telefonike, duke mos paraqitur asnjë pretendim për vlerësuesit.

3. Në vijim të procedurës së vlerësimit, pas shqyrtimit të dokumentacionit të dosjes së përcjellë nga organet e rivlerësimit kalimtar dhe dokumentacionit të dosjes personale të gjyqtares, ka rezultuar se; Z. {...} në periudhën tetor 2011- shtator 2014 ka ndjekur studimet në Shkollën e Magjistraturës. Gjatë kësaj periudhe, nga tetori 2013 deri në muajin korrik 2014 ka zhvilluar stazhin profesional pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë¹. Me dekretin e Presidentit të Republikës nr.8353, datë 25.09.2015, ajo është emëruar gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë.

4. Sa më sipër rezulton se, gjatë periudhës së vlerësimit tetor 2013-tetor 2016, znj. {...} ka ushtruar detyrën e gjyqtares në dy periudha:

- (i) Praktikën profesionale të vitit të tretë të Shkollës së Magjistraturës nga muaji tetor 2013 (21.10.2013) deri në muajin korrik 2014, për një kohëzgjatje prej 9 muajsh;
- (ii) Funkcionin e gjyqtares për periudhën 25.09.2015 deri në datë 08.10.2016, për një kohëzgjatje prej 1 vit 12 ditë. Gjatë kësaj periudhe ajo ka qenë me leje lindje nga muaji shkurt 2015- qershor 2015, duke u paraqitur në punë në datë 01.07.2016².

5. Pas konstatimeve si më sipër, KVEVP në mbledhjen e datës 12.01.2023 ka shqyrtuar propozimin e relatores së procedurës së vlerësimit dhe ka vendosur të miratojë propozimin për përfundimin pa vendim përfundimtar të procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin) e gjyqtarit, për periudhën e vlerësimit 2013-2016, të filluar ndaj gjyqtares {...} duke ia kaluar për shqyrtim çështjen Mbledhjes Plenare.

6. Në datë 23.01.2023 nëpërmjet postës elektronike, gjyqtares i është njoftuar relacioni mbi projektvendimin “Për përfundimin pa vendim përfundimtar të procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin), për periudhën e vlerësimit 2013-2016, për gjyqtaren {...}”, duke iu njoftuar njëkohësisht: (i) e drejta për të paraqitur kundërshtime/shpjegime me shkrim dhe (ii) e drejta për t’u dëgjuar në Mbledhjen Plenare të Këshillit, duke iu komunikuar data dhe ora e zhvillimit të mbledhjes. Gjyqtarja nuk ka konfirmuar marrjen dijeni, dhe as ka paraqitur kundërshtime lidhur me relacionin mbi projektvendimin.

¹ Me dekretin e Presidentit të Republikës nr.8353, datë 21.10.2013, është caktuar për të kryer stazhin profesional pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

² Sipas informacionit të marrë nga Burimet Njerzore të KLGJ, rezulton se nga data 01.02.2016- 01.07.2016 gjyqtarja ka qenë me leje lindje.

II. KUADRI LIGJOR I ZBATUESHËM

7. Lidhur me periudhën e stazhit profesional aktiv, në vitin e tretë të Shkollës së Magjistraturës, ligji i kohës nr.8136, datë 31.7.1996 “Për Shkollën e Magjistraturës së Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenin 14 parashikonte se : *“Formimi fillestar i kandidatëve përfshin një periudhë tre vjeçare që përbëhet nga:*

a) Një vit programi teorik me lëndë të ndryshme të së drejtës;

b) një vit praktikë nën kujdesin e një pedagogu të shkollës dhe nën drejtimin e një gjyqtari apo prokurori me kualifikim të lartë;

c) një vit praktik aktiv me ndjekjen e çështjeve më pak të komplikuar nën drejtimin e një gjyqtari ose prokurori (periudha e stazhit profesional).

Programi teorik sipas germës a) të nenit 14 është i përbashkët për të gjithë kandidatët, ndërsa viti praktik dhe viti i stazhit profesional zhvillohen sipas profileve që ka zgjedhur kandidati si gjyqtar ose prokuror..”.

8. Në nenin 19 të po këtij ligji, parashikohet se ; *“Në përfundim të periudhës së parashikuar në shkronjën "b" të nenit 14 të këtij ligji, sipas vlerësimit të bërë nga këshilli pedagogjik i shkollës, kandidatët për magistratë, sipas profileve të caktuara, caktohen përkohësisht për të kryer stazhin profesional si gjyqtarë dhe prokurorë nga Presidenti i Republikës, me propozimin, përkatësisht, të Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe të Prokurorit të Përgjithshëm.”*

9. Ndërsa në nenin 19/1 parashikohet se : *“Vlerësimi i këshillit pedagogjik bëhet me 5 shkallë: a) shkëlqyeshëm; b) shumë mirë; c) mirë; ç) mjaftueshëm; d) pamjaftueshëm. Rregullat dhe procedurat e vlerësimit përcaktohen në Rregulloren e Brendshme të Shkollës së Magjistraturës.*

10. Lidhur me vlerësimin e vitit të tretë, në nenin 20, paragrafi i parë i ligji, parashikohet se :*“Vlerësimi përfundimtar i kandidatëve bëhet nga këshilli pedagogjik, në bazë të rezultateve teorike dhe praktike të stazhit.”*

11. Po ashtu në Rregulloren e Brendshme të Shkollës së Magjistraturës, në nenin 27 të saj, në fuqi në momentin kur gjyqtari ka përfunduar stazhin e tij profesional, parashikohet se :
“Pas përfundimit të stazhit paraprofesional, kandidatët i nënshtrohen stazhit profesional, i cili konsiston në pjesëmarrjen aktive në ndjekjen e çështjeve më pak të komplikuar nën udhëheqjen e një gjyqtari ose prokurori...

Në fund të stazhit profesional bëhet vlerësimi i akteve dhe vendimeve të përpiluara nga kandidatët gjatë vitit. Secili prej tyre depoziton dosjen me materialet në sekretarinë shkencore në afatin e caktuar. Ndarja e dosjeve bëhet me short dhe vlerësimi bëhet nga Këshilli Pedagogjik i Shkollës së Magjistraturës.

III. ANALIZA LIGJORE E ÇËSHTJES

12. Referuar kuadrit ligjor dhe nënligjor të kohës, të referuar më sipër, rezulton se periudha e stazhit profesional, e cila zhvillohej gjatë gjithë vitit të tretë të Shkollës së Magjistraturës, ka qenë pjesë integrale e Programit të Formimit Fillestar dhe për pasojë, vlerësimi i veprimtarisë së gjyqtarës gjatë kësaj periudhe të ushtrimit të detyrës, i është nënshtruar vlerësimit profesional nga Shkolla e Magjistraturës, në kuadër të vlerëimit përfundimtar të kandidatëve, në përfundim të programit të formimit fillestar. Për pasojë, kjo periudhë e veprimtarisë profesionale nuk mund të bëhet objekt i një vlerësimi të dytë etik dhe profesional nga ana e Këshillit, pavarësisht se gjyqtarja {...} e ka pasur statusin e gjyqtarës edhe gjatë praktikës profesionale.

13. Vlerësimi etik dhe profesional që bëhet nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, për një periudhë të caktuar vlerësimi, nuk mund të mbivendoset me vlerësimin që bën vetë Shkolla e Magjistraturës, për të njëjtë periudhë vlerësimi, për kandidatët e vitit të 3/të Shkollës së Magjistraturës, për shkak se edhe pse për të njëjtën periudhë, kandidati i vitit të 3/të sipas ligjit të kohës, ka pasur statusin e gjyqtarit, i vetmi organ që ka pasur kompetencën e vlerëimit etik dhe profesional të tij ka qenë Shkolla e Magjistraturës, vlerësim mbi të cilin është bërë edhe pikëzimi dhe renditja e tij me rastin e diplomimit nga kjo Shkollë.

14. Gradimi i gjyqtarëve që kanë kaluar me sukses procesin e rivlerëimit kalimtar, për periudhën vlerësimi 2013-2016, mbështetet në përcaktimet e nenit 171, pika 5 të Ligjit për Statusin në të cilin parashikohet se: *“5. Pas vlerëimit të aftësive profesionale, të kryer nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, në kuadër të procesit të rivlerëimit, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ose Kolegji i Apelimit, në rast se është ushtruar e drejta e ankimit, i dërgon Këshillit dosjen me vlerësimin e kryer të magistratit, çdo dokument të përdorur në vlerësimin e aftësive profesionale, si dhe vendimin e formës së prerë të procesit të rivlerëimit. Nëse magistrati kalon me sukses procesin e rivlerëimit, **Këshillat vazhdojnë të bëjnë vlerësimin etik dhe profesional të magistratëve, në zbatim të ligjit, për aq sa është e mundur, me qëllim që të përcaktojnë gradën e vlerëimit përkatës** ”*. Në referim të këtij neni, analiza dhe konkluzionet e vendimit të formës së prerë të organeve të rivlerëimit kalimtar, konsiderohen të plota në lidhje me burimet që janë analizuar në kuadër të këtij procesi, vetëm në drejtim të qëllimit të identifikimit të gjyqtarëve që kanë arritur nivelin kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale. Shkalla e kësaj aftësie në nivelet : “shkëlqyeshëm”, “shumë mirë”, “mirë” apo “mjaftueshëm” përcaktohet në procesin e gradimit, pavarësisht konkluzioneve të organeve të vlerëimit lidhur më të.

15. Dispozita e mësipërme detyron Këshillin të bëjë gradimin e gjyqtarëve sipas Ligjit “Për Statusin”, vetëm nëse në zbatim të ligjit, ky vlerësim është i mundur. Me termin “Ligj” do të kuptohet jo vetëm Ligji për Statusin, por edhe Ligjet e tjera që afektojnë për shkak kompetence

të organit, gradimin e gjyqtarëve, sikundër është Ligji nr.8136, datë 31.7.1996 “Për Shkollën e Magjistraturës së Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, i cili për periudhën tetor 2013 deri në muajin korrik 2014, përcaktonte si organ kompetent Shkollën e Magjistraturës, për të bërë vlerësim etik dhe profesional për gjyqtarët në vitin e tretë të programit të formimit fillestar.

16. Lidhur me periudhën e ushtrimit të detyrës, pas emërimit të znj. {...}, në përfundim të programit të formimit fillestar, në raport me periudhën 3/vjeçare të vlerësimit 2013-2016, rezulton se ajo ka ushtruar detyrën pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, për periudhën 25.09.2015 deri në datë 08.10.2016, për një kohëzgjatje prej 1 vit e 12 ditë. Nëse vitin 2016 do ta konsiderojmë vit të plotë pune për efekt të periudhës së vlerësimit, kohëzgjatja e detyrës së gjyqtarës përkon me 1 vit, 4 muaj e 6 ditë. Gjatë kësaj periudhe vlerësimi, gjyqtarja ka qenë me leje lindje nga data 01.02.2016 deri datë 01.07.2016, pra për një periudhë prej 5 muajsh. Kështu, gjyqtarja ka ushtruar efektivisht detyrën e gjyqtarës për një periudhë prej 11 muaj e 6 ditë, deri në fund të muajit dhjetor 2016, ndërsa periudhën tjetër ajo ka kryer lejen e lindjes. Gjatë kësaj periudhe, gjyqtari gëzon statusin e gjyqtarit si dhe kjo periudhë i njihet për efekt të vjetërsisë në punë, në kushtet kur sipas nenit 8 paragrafi 3 të ligjit nr. 7703, datë 11.05.1992, “Për sigurimet shoqërore”, i ndryshuar si dhe nenit 9 paragrafi i parë i këtij ligji³, gjatë kësaj periudhe paguhen sigurimet shoqërore për efekt pensioni. Gjithashtu, sipas ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, kjo periudhë njihet dhe llogaritet si përvojë profesionale të gjyqtarit, edhe për efekt të përcaktimit të periudhës së vlerësimit, në ndryshim nga leja e papaguar, e cila nuk merret në konsideratë për vjetërsinë në punë ose për efekt të përfitimeve të tjera⁴.

17. Në nenin 84, pika 1 dhe 2 të Ligjit për Statusin, sa i përket periudhës së vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarës, parashikohet se : *“1. Magjistrati vlerësohet një herë në tre vjet, gjatë pesëmbëdhjetë viteve të para të përvojës profesionale, përfshirë edhe përvojën profesionale si ndihmës magjistrat ose magjistrat i komanduar.*
2. Magjistrati vlerësohet një herë në pesë vjet, pas 15 viteve të para të përvojës profesionale si magjistrat..””.

18. Në vendimin e Këshillit nr. 263, datë 21.11.2019 “Rregulla plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve”, lidhur me periudhën e vlerësimit, në nenin 5, parashikohet se :

³ Neni 8 paragrafi i tretë I ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë” parashikon se:” *Periudhë e mbrojtjes nga sigurimet shoqërore për efekt të pensionit të pleqërisë, pensionit të invaliditetit dhe të pensionit familjar është edhe periudha kur personi përfiton të ardhura nga sigurimet shoqërore për shkak sëmundjeje, barrë lindjeje, aksidenti në punë ose sëmundjeje profesionale dhe për papunësinë. Kontributet në favor të tyre do të transferohen nga llogaritë e degëve përkatëse”, dhe neni 9 paragrafi i parë parashikon se:” *Personat e punësuar dhe punëdhënësit e tyre janë të detyruar të paguajnë kontribut për sëmundje, barrë lindje dhe pensione në një shumë që varet nga paga e tyre totale (bruto). Kontributi nuk mund të caktohet nën një pagë minimale dhe mbi një pagë maksimale mujore.”**

⁴ Neni 24 pika 5 e ligjit nr.96/2016 parashikon se;”*Periudha e lejes së papaguar nuk merret në konsideratë për vjetërsinë në punë ose për efekt të përfitimeve të tjera.”*

1. Për çdo gjyqtar përcaktohet periudha e vlerësimit në bazë të viteve të përvojës profesionale sipas parashikimeve të nenit 84, pikat 1 dhe 2 të Ligjit për Statusin....

3. Periudha e vlerësimit përbëhet nga vite kalendarike dhe fillon në datën 1 janar të vitit të parë të periudhës së vlerësimit.

4. **Gjatë periudhës së vlerësimit, tre ose pesëvjeçare, Këshilli vlerëson gjyqtarin, pavarësisht nga koha e ushtrimit prej tij të detyrës, e cila gjithsesi nuk mund të jetë më pak se një vit.**”

19. Referuar kuadrit ligjor dhe nënligjor si më sipër, për znj. {...}, në kushtet kur rezultoi se koha e ushtrimit të detyrës që përfshihet në periudhën e vlerësimit 2013-2016, e cila përbën periudhë të plotë vlerësimi në kuptim të nenit 84 dhe 171/5 të Ligjit për Statusin, është më e shkurtër se një vit, sipas përcaktimeve të nenit 5, pika 4 të vendimit nr. 263, datë 21.11.2019, procedura e vlerësimit etik dhe profesional të filluar për periudhën 3/vjeçare që përfshin vitet 2013-2016, nuk mund të vazhdojë. Përcaktimi i këtij kufiri kohor minimal 1/vjeçar, është miratuar nga Këshilli, për të mundësuar kryerjen efektive të vlerësimit me të dhëna dhe materiale të nevojshme për vlerësim.

20. Sa më sipër, në kushtet kur gjyqtarja pas përfundimit të Shkollës së Magjistraturës, nuk rezulton të ketë ushtruar veprimtarinë profesionale për një kohëzgjatje minimale prej një viti, brenda periudhës së vlerësimit 2013-2016, rezulton se, objekti për të cilin ka filluar procedura e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin) është i pamundur të realizohet dhe për pasojë, zhvillimi i kësaj procedure vlerësimi nuk mund të vazhdojë, pasi gjyqtarja nuk ka ushtruar detyrën për një kohë të mjaftueshme gjatë periudhës së vlerësimit, për të mundësuar vlerësimin e tij etik dhe profesional.

21. Në ligjin nr.96/2016 nuk ka një parashikim të shprehur për përfundimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional pa vendim përfundimtar, ndërkohë që në nenin 7 të vendimit të KLGJ-së nr.263, datë 21.11.2019, parashikohet vetëm përfundimi pa vendim përfundimtar i procedurës së vlerësimit në rastet e mbarimit të statusit të gjyqtares. Pavarësisht se në aktet e sipërcituara nuk ka një përcaktim të shprehur që rregullon situatën faktike në fjalë, në zbatim të nenit 97 pika 3 të Ligjit 115/2016 “Për organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, Këshilli zbaton K.Pr.A, në nenin 95 të së cilit parashikohet se : “*Organi publik deklaron të përfunduar procedurën administrative pa një vendim përfundimtar për çështjen, kur objekti për të cilin kishte nisur procedura apo qëllimi i tij është bërë i pamundur*”.

IV. KONKLUZIONI

22. Në përfundim, pasi analizoi faktet e çështjes, parashikimet e ligjit të zbatueshëm, Këshilli vlerëson se, për Znj {...}, realizimi i procedurës së vlerësimit etik dhe profesional sipas parashikimeve të nenit 171/5 të Ligjit për Statusin, të filluar me vendimin nr. 440, datë 01.11.2022, është objektivisht i pamundur dhe si i tillë nuk mund të vazhdojë.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 147/a, pika 1, shkronja “a” dhe “ë” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 85 e vijues të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenet 61 pika 1, 63 dhe 86 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në nenin 95 të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, dhe në Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 263 datë 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve”, Këshilli i Lartë Gjyqësor,

V E N D O S I :

1. Përfundimin pa vendim përfundimtar të procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin) e gjyqtarës {...}, për periudhën e vlerësimit 2013-2016.
2. Një kopje e vendimit t’i njoftohet Znj. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimitetit.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR